

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	DRAFT Projektligj “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Ky ligj është plotësisht me Direktivën (BE) 2009/125 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Tetor 2009, “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energjisë”, Numri CELEX 32009L0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 285, datë 31.10.2009, f. 10–35
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	1. Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”. 2. Ligj Nr. 37/2025 “Për Performancën Energjetike të Ndërtesave”. 3. Ligj Nr. 138/2013 “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”. 4. Vendim Nr. 872, datë 29.12.2021 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën”. 5. Plani Kombëtar i Përshtatjes së Shqipërisë. Raporti i parë i Progresit (Mars 2023) 6. Ligji 52/2024 “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	30/09/2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Jo
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti– ML – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Keti Gjinali keti.gjinali@infrastruktura.gov.al +355695622689
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Problemi lidhet me mungesën e një kuadri të posaçëm ligjor për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji, gjë që ka lejuar qarkullimin në treg të produkteve joeficiente, me konsum të lartë energjie dhe ndikim negativ në mjedis. Këto produkte shpesh kanë jetë të shkurtër përdorimi, riparueshmëri të kufizuar dhe mungesë mundësish për riciklim, duke rritur volumin e mbetjeve elektrike dhe elektronike, si dhe kostot për konsumatorët dhe shoqërinë.

Në mungesë të standardeve të detyrueshme, importuesit dhe shpërndarësit favorizojnë teknologjitë më të lira, të cilat nuk janë gjithmonë të qëndrueshme dhe nuk përputhen me praktikën e Bashkimit Evropian. Kjo situatë e vë Shqipërinë në vështirësi për të përmbushur objektivat e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK 2021–2030), të cilat parashikojnë reduktimin e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazeve serrë, si dhe të Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike 2019–2030.

Një problem tjetër është mungesa e transparencës dhe informacionit të plotë për konsumatorët, të cilët nuk kanë mjetet e nevojshme për të bërë zgjedhje të informuara mbi konsumin e energjisë dhe ndikimet mjedisore të produkteve që vendosen në treg. Kjo cenon njëkohësisht edhe parimet e Ligjit nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” dhe të Ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të cilat kërkojnë promovimin e qëndrueshmërisë dhe reduktimin e mbetjeve.

Nëse nuk ndërhyhet, kjo situatë do të thellojë problemet e konsumit joeficient të energjisë, do të kufizojë përparimin drejt objektivave klimatike dhe do të vonojë përafrimin me kuadrin ligjor evropian për projektimin ekologjik.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Ky projektligj për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji synon të krijojë një kuadër të detyrueshëm ligjor, të harmonizuar me Direktivën 2009/125/KE, me qëllim që të garantojë përdorimin e qëndrueshëm të energjisë dhe burimeve natyrore. Objektivat e tij lidhen ngushtë me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021–2030 (PKEK), Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike, si dhe me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe procesit të anëtarësimit në BE.

Objektivat kryesorë

1. Rritja e eficiencës së energjisë në nivel produkti dhe konsumatori

Përmes vendosjes së standardeve të detyrueshme të projektimit ekologjik, të gjitha produktet që vendosen në tregun shqiptar do të kenë performancë më të lartë energjetike dhe jetëgjatësi më të madhe, duke kontribuar në objektivin e PKEK për reduktimin e konsumit final të energjisë me 8.4% deri në vitin 2030.

2. Kontribut në uljen e emetimeve të gazeve me efekt serrë (GHG)

Masat e reja do të ndihmojnë në reduktimin e konsumit të energjisë elektrike nga burime të larta karboni dhe në uljen e mbetjeve. Në këtë mënyrë, projektligji mbështet objektivin kombëtar për reduktim me 18.7% të emetimeve të gazeve serrë deri në vitin 2030, siç përcaktohet në PKEK.

3. Promovimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe ekonomisë qarkulluese

Duke vendosur kërkesa mbi riparueshmërinë, riciklueshmërinë dhe zgjatjen e ciklit jetësor të produkteve, ligji redukton gjenerimin e mbetjeve dhe harmonizohet me parashikimet e Ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe me parimet e Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike.

4. Përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe integrimi në tregjet evropiane

Përputhja e produkteve të vendosura në treg me kërkesat e BE-së krijon kushte të barabarta konkurrence dhe ndihmon Shqipërinë të rrisë besueshmërinë në tregun rajonal dhe evropian, duke shmangur barrierat teknike tregtare.

5. Fuqizimi i konsumatorëve për zgjedhje të informuar

Etiketimi i detajuar mbi konsumin e energjisë dhe ndikimin mjedisor i jep konsumatorëve mundësinë të bëjnë zgjedhje më të ndërgjegjshme dhe më ekonomike, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e kostove të energjisë për familjet shqiptare.

6. Nxitja e inovacionit dhe investimeve në teknologji të pastra

Bizneset, duke iu përshtatur kërkesave të reja, do të investojnë më shumë në teknologji e procese të qëndrueshme, duke hapur mundësi të reja pune në sektorë si prodhimi i pajisjeve eficiente, shërbimet e riparimit, riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

7. Rritja e kapaciteteve institucionale dhe forcimi i mbikëqyrjes së tregut

Përmes mekanizmave të rinj ligjorë dhe organizativë, inspektimet dhe monitorimi i tregut do të bëhen më efektive, duke garantuar respektimin e standardeve evropiane dhe duke forcuar besimin e publikut.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

OPSIONI 0 - Status quo (Pa ndryshime në ligj)

Vazhdimi me kuadrin ekzistues ligjor, pa miratim të ligjit për projektimin ekologjik.

Avantazh: nuk krijohen kosto shtesë për operatorët ekonomikë dhe institucionet publike në afatshkurtër.

Disavantazh: tregu mbetet i pambrojtur nga produkte joeficiente, konsumatorët nuk përfitojnë kursime, Shqipëria rrezikon të mos përmbushë objektivat e NECP dhe të marrë penalitete nga BE.

OPSIONI 1 – Udhëzime jo detyruese

Përdorimi i akteve nënligjore ose udhëzuesve jo detyrues për të orientuar prodhuesit dhe importuesit drejt produkteve më efikase.

Avantazh: fleksibilitet për biznesin dhe ulje e barrierave administrative.

Disavantazh: mungesë efekti të detyrueshëm, zbatim i pjesshëm dhe i pabarabartë në treg, mbetet rreziku i qarkullimit të produkteve joeficiente.

OPSIONI 2 – Ligj i posaçëm për projektimin ekologjik (Opsioni i preferuar)

Miratimi i kërkesave ligjore të detyrueshme për projektimin ekologjik, të harmonizuara me Direktivën 2009/125/EC.

Avantazh: reduktim real i konsumit të energjisë, rritje e transparencës për konsumatorët, përmbushje e detyrimeve ndaj BE-së, nxitje e inovacionit dhe zhvillim i tregut të gjelbër.

Disavantazh: kosto fillestare për operatorët dhe institucionet publike, të cilat kompensohen afatmesëm me përfitime më të mëdha.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Nga shqyrtimi i opsioneve, opsioni i preferuar është Opsioni 2 – miratimi i ligjit për projektimin ekologjik. Kjo politikë buron nga angazhimi i Shqipërisë në kuadër të Agjendës së Reformës / Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke transpozuar Direktivën 2009/125/EC dhe duke reflektuar dispozitat e Rregullores (BE) 2024/1781 për produktet me ndikim në energji. Qëllimi është krijimi i një kuadri ligjor të plotë, që siguron përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe reduktimin e ndikimit mjedisor gjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve.

Ndikimet sasiore (monetare):

Fillimisht priten kosto të kufizuara për bizneset dhe operatorët ekonomikë, veçanërisht për përshtatjen me kërkesat e projektimit ekologjik dhe krijimin e pasaportës digjitale të produktit. Këto kosto lidhen me testimet, certifikimin, mbajtjen e të dhënave dhe përditësimin e sistemeve të informacionit. Gjithashtu, strukturat e mbikëqyrjes së tregut do të kenë nevojë për burime shtesë për inspektime dhe trajnime. Megjithatë, në afatmesëm e afatgjatë, këto shpenzime kompensohen nga kursimet e energjisë për konsumatorët, ulja e kostove të mirëmbajtjes për bizneset dhe përfitime nga rritja e konkurrueshmërisë në tregun e BE-së.

Ndikimet cilësore (narrative):

- Konsumatorët përfitojnë nga transparenca më e madhe, me akses në produkte më jetëgjata, më të riparueshme dhe me kosto më të ulëta operative.
- Bizneset, përfshirë NVM-të, nxiten të investojnë në teknologji moderne dhe inovacion, duke siguruar avantazh konkurrues në treg dhe duke krijuar mundësi të reja për rritje.
- Institucionet publike do të zbatojnë praktika të prokurimit të gjelbër dhe do të reduktojnë konsumin e energjisë në shërbimet që ofrojnë, në përputhje me ligjin për eficiencën e energjisë dhe PKEK.
- Shoqëria përfiton nga rritja e ndërgjegjësimit publik, hapja e vendeve të reja të punës në sektorët e riparimit, riciklimit dhe shërbimeve të gjelbra, si dhe nga përmirësimi i cilësisë së jetesës.
- Mjedisi përfiton nga reduktimi i konsumit të energjisë, ulja e emetimeve të gazeve serrë në përputhje me objektivin e PKEK për reduktimin me 18.7% të GHG deri në vitin 2030, dhe nga zvogëlimi i mbetjeve përmes rritjes së riciklueshmërisë dhe përdorimit të materialeve të qëndrueshme.

- Autoritetet e kontrollit të tregut do të kenë mjete më të fuqishme për të luftuar praktikatat e padrejta tregtare dhe për të parandaluar hyrjen e produkteve jo-konformë në treg.

Në përfundim, ndikimet janë pozitive dhe të qëndrueshme në plan afatgjatë, duke sjellë përfitime të dukshme për konsumatorët, bizneset, mjedisin dhe administratën publike, ndërkohë që kostoja fillestare për përshtatjen e tregut është e justifikuar dhe e përballueshme në raport me përfitimet e përgjithshme.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është Opsioni 2 – miratimi i projektligjit për projektimin ekologjik, sepse:

1. Forcon kuadrin rregullator kombëtar, duke mbushur boshllëkun ekzistues në legjislacionin shqiptar dhe duke e lidhur atë me objektivat strategjike të qeverisë për tranzicionin e gjelbër, eficiencën e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Agjendën e Reformës dhe Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor.
2. Siguron harmonizim me acquis të BE-së, përmes transpozimit të Direktivës 2009/125/EC dhe duke marrë në konsideratë dispozitat e Rregullores (BE) 2024/1781. Edhe pse draft-ligji i Shqipërisë mbulon vetëm produktet me ndikim në energji, përputhja me rregulloren e re e përgatit vendin për integrimin gradual të kërkesave më të detajuara dhe specifike që do të shtrihen në vitet në vijim.
3. Vendos kërkesa të qarta dhe të detyrueshme për produktet, duke përcaktuar standarde për eficiencën e energjisë, jetëgjatësinë, riparueshmërinë dhe riciklueshmërinë, çka ul konsumin energjetik, zvogëlon gjenerimin e mbetjeve dhe u jep konsumatorëve produkte më cilësore me kosto më të ulëta gjatë përdorimit.
4. Kontribuon në përmbushjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare, duke mbështetur zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2021–2030 dhe Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike. Ligji gjithashtu lidhet drejtpërdrejt me Marrëveshjen e Parisit dhe Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, duke kontribuar në objektivin e reduktimit të emetimeve të GHG me 18.7% deri në vitin 2030.
5. Ka kosto të kufizuara për buxhetin e shtetit, të lidhura kryesisht me mbikëqyrjen e tregut dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale. Këto kosto pritet të mbulohen nga tarifat e kontrollit dhe nga mbështetja e BE-së dhe partnerëve të zhvillimit. Përfitimet afatgjata ekonomike (kursime energjie dhe ulje e faturave), sociale (vende pune të reja në riparim, riciklim dhe ekonomi qarkulluese) dhe mjedisore (ulje e ndotjes dhe e mbetjeve) i tejkalojnë dukshëm këto shpenzime fillestare.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

Ky projektligj nuk ka kosto mbi buxhetin e shtetit
KONSULTIMI <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)</i>
ZBATIMI DHE MONITORIMI <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)</i> Zbatimi i projektligjit do të organizohet përmes një koordinimi institucional të qartë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të mbetet institucioni përgjegjës kryesor për hartimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e politikave në fushën e eficiencës së energjisë dhe projektimit ekologjik, duke siguruar edhe përafrimin me legjislacionin e BE-së. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) do të ketë rolin operativ për inspektimin e produkteve të vendosura në treg dhe për verifikimin e pajtueshmërisë së tyre me kërkesat ligjore. ISHMT përgatit programin vjetor të inspektimeve dhe raporton rezultatet tek MIE, e cila më tej i përcjell ato pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu, autoritetet doganore do të angazhohen në kontrollin kufitar për të parandaluar hyrjen e produkteve që nuk përmbushin standardet. Ky sistem i kombinuar garanton monitorim të vazhdueshëm, transparencë dhe rishikim periodik të politikës, duke u mbështetur në objektivat e NECP dhe në detyrimet e Agjendës së Reformës për Ballkanin Perëndimor.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Politika për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji buron nga zhvillimet e Bashkimit Evropian në fushën e eficiencës së energjisë, ekonomisë qarkulluese dhe mbrojtjes së mjedisit. Direktiva 2009/125/EC, e miratuar në vitin 2009, vendosi kornizën ligjore për përcaktimin e kërkesave të detyrueshme mbi projektimin ekologjik të produkteve që lidhen me energjinë, duke synuar përmirësimin e performancës energjetike dhe mjedisore gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre – nga projektimi dhe prodhimi, deri te përdorimi dhe trajtimi si mbetje. Kjo direktivë shënoi një hap thelbësor drejt ndërtimit të një tregu të përbashkët evropian për produkte më eficiente dhe më miqësore me mjedisin.

Në kuadër të Agjendës së Reformës / Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, Shqipëria mori angazhimin për transpozimin e kësaj direktive si pjesë e detyrimeve të integritit evropian dhe si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë. Ndërkohë, BE ka avancuar duke miratuar Rregulloren (BE) 2024/1781, e cila zëvendëson Direktivën 2009/125/EC dhe vendos një kuadër të përditësuar, me kërkesa më të detajuara për produkte të ndryshme, duke reflektuar prioritetet e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe objektivin e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Shqipëria, përmes këtij projektligji, synon të transpozojë Direktivën 2009/125/EC dhe të integrojë elementë përkatës nga Rregullorja

2024/1781 që lidhen drejtpërdrejt me produktet me ndikim në energji, duke garantuar një qasje të qëndrueshme dhe të harmonizuar me standardet evropiane.

Në vitin 2024, Shqipëria miratoi Ligjin nr. 52/2024 “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, i cili transpozoi Rregulloren (BE) 2017/1369. Ky ligj krijoi bazën ligjore për informimin e konsumatorëve mbi konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera nga produktet e vendosura në treg, duke u bërë një element thelbësor për fuqizimin e konsumatorit dhe për rritjen e transparencës. Projektligji i ri për projektimin ekologjik e plotëson këtë kuadër, duke adresuar jo vetëm informimin e konsumatorit, por edhe vetë cilësinë dhe karakteristikat teknike të produkteve, të cilat duhet të përmbushin standarde të qëndrueshmërisë, jetëgjatësisë, riparueshmërisë dhe riciklueshmërisë.

Në këtë mënyrë, etiketimi dhe projektimi ekologjik funksionojnë si dy mekanizma plotësues: i pari i jep konsumatorit informacion për të zgjedhur më mirë, ndërsa i dyti siguron që vetë produktet e ofruara në treg të përmbushin standardet më të larta të eficiencës dhe të ndikimit mjedisor. Kjo qasje e integruar rrit transparencën, përmirëson funksionimin e tregut dhe kontribuon në reduktimin e kostove për konsumatorët dhe bizneset.

Projektligji për projektimin ekologjik është gjithashtu një instrument kyç për të përmbushur objektivat kombëtare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2021–2030, si dhe në Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike 2019–2030. Ai kontribuon në uljen e konsumit të energjisë, rritjen e eficiencës së produkteve, si dhe në reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në përputhje me objektivin e vendit për uljen me 18.7% deri në vitin 2030.

Kjo nismë e re, e ndërtuar mbi përvojën e Ligjit 52/2024, jo vetëm që forcon kapacitetin institucional dhe kuadrin rregullator për mbikëqyrjen e tregut, por edhe afron Shqipërinë me modelin evropian të tranzicionit të gjelbër dhe ekonomisë qarkulluese, duke hapur mundësi për investime, inovacion dhe vende të reja pune në sektorë strategjikë si riparimi, riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Shqipëria nuk ka ende një kuadër të posaçëm ligjor për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji, pavarësisht se kjo përbën një kërkesë të drejtpërdrejtë të acquis të BE-së dhe një angazhim të marrë në kuadër të Agjendës së Reformës / Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Mungesa e këtij kuadri ligjor ka krijuar një boshllëk rregullator, pasi produktet që hyjnë në tregun vendas janë kryesisht të importuara dhe nuk i nënshtrohen detyrimeve të qarta mbi eficiencën e energjisë, jetëgjatësinë, riparueshmërinë dhe riciklueshmërinë. Në mungesë të standardeve të

unifikuara, tregu shqiptar bëhet një destinacion i lehtë për produkte me cilësi të ulët, të cilat rrisin konsumin e energjisë, shpenzimet e familjeve dhe prodhimin e mbetjeve elektrike e elektronike.

Kjo situatë nuk është vetëm një çështje teknike, por prek drejtpërdrejt përmbushjen e objektivave të vendit në sektorin e energjisë dhe klimës. Sipas Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP 2021–2030), Shqipëria synon të reduktojë konsumin final të energjisë dhe të ulë emetimet e gazeve serrë me 18.7% deri në vitin 2030. Megjithatë, pa instrumentin e projektimit ekologjik, që rregullon kushtet mbi cilësinë dhe performancën e produkteve gjatë gjithë ciklit jetësor, këto objektivat rrezikojnë të mbeten në letër. Po ashtu, mungesa e këtij kuadri bie ndesh me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike 2019–2030, e cila parashikon forcimin e mekanizmave për reduktimin e konsumit të burimeve dhe të gjurmës së karbonit, si dhe me objektivat e Ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që kërkon uljen në burim të mbetjeve dhe rritjen e riciklimit.

Problemi shtrihet gjerësisht:

- Qeveria mbetet pa instrumente të mjaftueshme për të ushtruar kontroll mbi cilësinë e produkteve të vendosura në treg dhe për të garantuar përputhjen me objektivat e politikave klimatike dhe energjetike.
- Bizneset importuese dhe tregtare përballen me një situatë të pasigurt, pasi mungesa e rregullave të qarta kufizon konkurrueshmërinë e tyre në tregjet e BE-së dhe pengon investimet afatgjata.
- Konsumatorët detyrohen të përdorin produkte joeficiente, që gjenerojnë fatura të larta energjie dhe kanë jetë të shkurtër përdorimi, duke u privuar nga e drejta për zgjedhje të informuar.
- Shoqëria civile dhe komuniteti i gjerë ndikohet nga rritja e mbetjeve, konsumi i panevojshëm i burimeve natyrore dhe shtimi i presioneve mbi mjedisin.

Ky problem nuk mund të trajtohet me masa fragmentare administrative, pasi kërkon një ndërhyrje ligjore të integruar, e cila të transpozojë Direktivën 2009/125/EC dhe të reflektojë dispozitat përkatëse të Rregullores (BE) 2024/1781. Vetëm një instrument i tillë ligjor mund të garantojë harmonizimin gradual me standardet evropiane, të mbështesë zbatimin e Ligjit 52/2024 për etiketimin e produkteve me ndikim në energji dhe të krijojë bazën për një treg transparent, të qëndrueshëm dhe në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria shqiptare e sheh të domosdoshme ndërhyrjen në fushën e projektimit ekologjik të produkteve me ndikim në energji për të adresuar boshllëkun ligjor që ekziston aktualisht dhe për të garantuar përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian. Në mungesë të një kuadri të posaçëm, tregu shqiptar

është i ekspozuar ndaj produkteve të importuara joeficiente, me jetë të shkurtër përdorimi, të vështira për t'u riparuar ose ricikluar, që rrisin faturat e energjisë për familjet, shtojnë volumnin e mbetjeve dhe kufizojnë aftësinë konkurruese të bizneseve.

Ndërhyrja synon të mbrojë konsumatorët nga produkte joeficiente dhe të pasiguruara, të forcojë transparencën për zgjedhje të informuara dhe të krijojë kushte për një treg të ndershëm dhe të harmonizuar me rregullat e BE-së. Ajo adreson sfida që lidhen drejtpërdrejt me interesin publik, zhvillimin e qëndrueshëm dhe procesin e integritit evropian. Ky projektligj përfaqëson hapin pasues të miratimit të Ligjit 52/2024 për etiketimin e produkteve me ndikim në energji, duke shtrirë logjikën e reformës nga informimi i konsumatorëve te vendosja e kërkesave të detyrueshme për projektimin dhe performancën e produkteve.

Kjo ndërhyrje është pjesë integrale e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Agjendës së Reformës / Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, si dhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi klimën dhe energjinë. Ajo mbështet objektivat e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (2021–2030), që synon reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë me 18.7% deri në vitin 2030, dhe kontribuon në përmbushjen e detyrimeve të Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike 2019–2030 dhe të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Në kuadrin e integritit evropian, miratimi i këtij ligji lidhet drejtpërdrejt me Kapitullin 1 (Liria e lëvizjes së mallrave), pasi garanton standarde të harmonizuara për produktet që hyjnë në treg, duke eliminuar barrierat teknike dhe duke lehtësuar qarkullimin e lirë të produkteve në tregun e përbashkët evropian. Po ashtu, ai mbështet zbatimin e detyrimeve të Kapitullit 15 (Energji) dhe Kapitullit 27 (Mjedis), duke e vendosur Shqipërinë në një pozicion më të fortë negociues në procesin e anëtarësimit.

Qeveria ka ndërmarrë tashmë hapa të rëndësishëm përgatitorë: miratimin e ligjit për etiketimin e produkteve me ndikim në energji, rishikimin e kuadrit ligjor për eficiencën e energjisë dhe performancën e ndërtesave, ngritjen e mekanizmave për monitorimin e objektivave klimatike dhe hartimin e akteve nënligjore mbështetëse. Projektligji i ri për projektimin ekologjik plotëson këtë mozaik reformash duke vendosur bazën ligjore për të kontrolluar kushtet me të cilat produktet futen në treg, duke nxitur përdorimin më të mençur të energjisë dhe burimeve natyrore, forcimin e ekonomisë qarkulluese dhe zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm e konkurrues.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Projektligji “Për përcaktimin e kërkesave të projektimit ekologjik të produkteve me ndikim në energji” synon të plotësojë boshllëkun ligjor që ekziston aktualisht në Shqipëri dhe të garantojë që çdo produkt i tillë i vendosur në treg, qoftë i importuar apo potencialisht i prodhuar në të ardhmen, të respektojë standarde të qarta dhe të detyrueshme. Ky objektiv ka disa dimensione

kryesore, që lidhen me energjinë, mjedisin, konsumatorët, biznesin dhe procesin e integritimit evropian.

1. Objektivi strategjik dhe ligjor

Qëllimi parësor është përafrimi i kuadrit shqiptar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, përmes transpozimit të Direktivës 2009/125/EC mbi projektimin ekologjik dhe integritimit të elementëve të Rregullores (BE) 2024/1781, duke ndjekur modelin evropian të ekonomisë qarkulluese. Kjo ndërhyrje do të garantojë që produktet e vendosura në tregun shqiptar të kenë të njëjtin nivel sigurie, transparence dhe performance si ato të tregut të BE-së, duke përgatitur vendin për hapjen dhe mbylljen e kapitujve të integritimit, veçanërisht Kapitullit 1 (Liria e lëvizjes së mallrave) dhe Kapitullit 15 (Energji).

2. Objektivi energjetik

Një ndër qëllimet themelore është ulja e konsumit të energjisë në nivel kombëtar, në përputhje me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2021–2030, i cili përcakton një target për reduktim të konsumit final të energjisë me 8.4% deri në vitin 2030. Projektligji siguron që produktet e vendosura në treg të jenë më eficiente, duke përmirësuar ndjeshëm performancën energjetike të sektorit rezidencial, publik dhe privat, si dhe duke ulur varësinë nga importet e energjisë, të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit dhe bilancin tregtar.

3. Objektivi klimatik dhe mjedisor

Projektligji mbështet objektivat e Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike dhe të Marrëveshjes së Parisit, duke kontribuar në uljen e emetimeve të gazeve me efekt me 18.7% deri në vitin 2030. Kërkesat për jetëgjatësi, riparueshmëri dhe riciklueshmëri të produkteve pritet të sjellin një reduktim të ndjeshëm të mbetjeve elektronike dhe të pajisjeve elektrike, duke ulur presionin mbi sistemin e menaxhimit të mbetjeve dhe duke mbështetur zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Në këtë mënyrë, objektivi nuk kufizohet vetëm te kursimi i energjisë, por shtrihet edhe në uljen e gjurmës së karbonit dhe përdorimin më të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

4. Objektivi për mbrojtjen e konsumatorëve

Një synim qendror është transparenca e informacionit. Konsumatorët shqiptarë do të pajisen me të dhëna të qarta dhe të krahasueshme për konsumin e energjisë, koston afatgjatë dhe ndikimin mjedisor të produkteve. Kjo do t'u mundësojë atyre zgjedhje të informuara, duke shmangur blerjen e produkteve joeficiente, të cilat rrisin faturat e energjisë dhe kanë jetë të shkurtër. Në këtë mënyrë, objektivi lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, si një prioritet i politikave publike dhe i procesit të integritimit evropian.

5. Objektivi për zhvillimin ekonomik dhe tregun

Në aspektin ekonomik, objektivi është të krijohet një treg më konkurrues dhe i ndershëm, ku produktet joeficiente eliminohen, ndërsa bizneset që respektojnë standardet fitojnë avantazh. Politika synon të nxisë inovacionin teknologjik, duke hapur mundësi për investime të reja, vende pune dhe zhvillimin e sektorëve mbështetës si riparimi, riciklimi dhe shërbimet e ekonomisë qarkulluese. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, objektivi është të sigurohet mbështetje

teknike dhe financiare për përshtatjen me standardet e reja, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e tyre si në tregun vendas ashtu edhe në atë evropian.

6. Objektivi institucional dhe ligjor

Një qëllim i rëndësishëm është të forcohen kapacitetet e institucioneve shtetërore që do të zbatojnë dhe monitorojnë këtë politikë, kryesisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Objektivi është të sigurohet një sistem funksional kontrolli, përmes planeve vjetore të inspektimit, laboratorëve të akredituar për testim dhe mekanizmave të raportimit, në mënyrë që zbatimi të jetë efektiv dhe i matshëm.

7. Objektivi afatgjatë i zhvillimit të qëndrueshëm

Në fund, objektivi përfundimtar është të kontribuojë në tranzicionin drejt neutralitetit klimatik deri në vitin 2050, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Përmes këtij projektligji, Shqipëria jo vetëm që përmbush detyrimet ndërkombëtare dhe përgatitet për anëtarësim në BE, por edhe garanton një zhvillim të qëndrueshëm që balancon nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Në kuadër të hartimit të projektligjit “Për përcaktimin e kërkesave të projektimit ekologjik të produkteve me ndikim në energji” u shqyrtuan disa alternativa të mundshme të politikave, duke filluar nga mosveprimi deri te përafrimi i plotë me standardet e Bashkimit Evropian. Identifikimi i opsioneve është bërë mbi:

- analizën e kuadrit ligjor aktual dhe boshllëqeve ekzistuese në Shqipëri;
- krahasimin me acquis të BE-së dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare;
- referencën ndaj dokumenteve strategjike kombëtare dhe rajonale, përfshirë Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021–2030 (PKEK), Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike, si dhe Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE);
- konsultimet me aktorët kryesorë: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile.

Opsioni 0 – Status quo (mosndryshimi i kuadrit ligjor)

Ky opsion parashikon vijimin me gjendjen aktuale, ku mungon një ligj i posaçëm për projektimin ekologjik dhe tregu shqiptar funksionon me rregullime të pjesshme, kryesisht përmes ligjit të etiketimit të energjisë (Ligji nr. 52/2024). Në këtë skenar, produktet me ndikim në energji do të vazhdonin të futeshin në treg pa standarde të unifikuara mbi jetëgjatësinë, riparueshmërinë dhe riciklueshmërinë. Kjo do të nënkuptonte:

- vazhdimin e furnizimit të tregut me produkte joeficiente dhe me cilësi të ulët;

- mungesë informacioni dhe transparence për konsumatorët;
- mospërputhje me acquis të BE-së, duke e lënë Shqipërinë prapa në procesin e integritimit;
- rrezik që masat e PKEK dhe objektivat për reduktimin e konsumit të energjisë (8.4% deri në 2030) dhe të emetimeve të GHG (18.7%) të mos arrihen.

Në analizë afatgjatë, ky opsion është i papranueshëm, pasi nuk i përgjigjet detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Agjendës së Reformës / Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe as pritshmërive të qytetarëve për një treg më të rregulluar.

Opsioni 1 – Ndryshime të pjesshme të kuadrit ligjor

Ky opsion parashikon përfshirjen vetëm të disa elementeve të Direktivës 2009/125/EC në legjislacionin shqiptar. Ai do të sillte një përmirësim të pjesshëm, duke futur disa standarde bazë të projektimit ekologjik, por pa arritur të pasqyrojë zhvillimet më të fundit të Rregullores (BE) 2024/1781. Për pasojë:

- tregu do të harmonizohej vetëm pjesërisht me BE-në, duke lënë boshllëqe për disa kategori produktesh;
- bizneset do të përballeshin me pasiguri dhe kosto tranzicioni të pakoordinuara;
- konsumatorët do të merrnin informacion të kufizuar dhe jo të unifikuar;
- objektivat e politikave klimatike dhe energjetike do të mbeteshin të vështira për t'u arritur, pasi mungesa e një kuadri të plotë nuk do të krijonte efektet sinergjike të nevojshme. Ky opsion do të kishte një ndikim pozitiv afatshkurtër, por do të konsiderohej një zgjidhje gjysmake, që do të shtynte në kohë përafrimin e plotë dhe do të krijonte kosto shtesë për bizneset në momentin kur përafrimi do të bëhej i detyrueshëm.

Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri për projektimin ekologjik (opsioni i preferuar)

Ky opsion përfshin hartimin dhe miratimin e një ligji të posaçëm që:

- transponon Direktivën 2009/125/EC për projektimin ekologjik;
- integron elementët përkatës të Rregullores (BE) 2024/1781, të cilat lidhen me produktet me ndikim në energji dhe pasaportën digjitale të produktit;
- krijon një kuadër ligjor të plotë për vendosjen e kërkesave mbi eficiencën e energjisë, jetëgjatësinë, riparueshmërinë dhe riciklueshmërinë;
- siguron informacion të standardizuar për konsumatorët, duke forcuar transparencën dhe konkurrencën e ndershme;
- përgatit Shqipërinë për përafrime të mëtejshme ligjore në sektorë të tjerë të lidhur me ekonominë qarkulluese dhe tranzicionin e gjelbër.

Ky opsion është vlerësuar si më i përshtatshmi pasi:

- mbështet objektivat e PKEK dhe Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike, duke kontribuar në uljen e konsumit dhe në reduktimin e emetimeve;
- forcon besimin e konsumatorëve dhe rrit cilësinë e tregut;
- krijon kushte për zhvillimin e sektorëve të rinj ekonomikë, si riparimi dhe riciklimi;
- garanton përputhshmëri të plotë me angazhimet ndërkombëtare dhe integrimin evropian.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni grupet e prekura.
 - Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
 - Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).
 - Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
 - Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
 - Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).
- Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Grupet e prekura

Nga kjo nismë ligjore preken drejtpërdrejt dhe tërthorazi këto grupe:

- Konsumatorët fundorë, që blejnë dhe përdorin produkte me ndikim në energji.
- Bizneset dhe ndërmarrjet, përfshirë NVM-të, të cilat duhet të përshtatin proceset e tyre të projektimit, importit dhe shitjes me standardet e reja.

- Importuesit dhe tregtarët, të cilët do të duhet të sigurojnë që produktet e tyre të jenë të certifikuara dhe të pajisura me informacion të standardizuar mbi performancën.
- Institucionet publike, kryesisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), doganat dhe organet e tjera mbikëqyrëse.
- Shoqëria civile dhe publiku i gjerë, të cilët përfitojnë nga ndikimet në mjedis, shëndet publik dhe cilësi të jetesës.

Ndikimet e drejtpërdrejta

Konsumatorët

- Cilësore: marrin informacion të qartë dhe të krahasueshëm mbi konsumin energjetik, jetëgjatësinë dhe riciklueshmërinë e produkteve; fuqizohen për zgjedhje të vetëdijshme; fitojnë më shumë besim në treg.
- Sasiore: kursime mesatare në faturat e energjisë që mund të arrijnë deri në 10–15% në afatgjatë, në varësi të kategorisë së produkteve; ulje e kostove të mirëmbajtjes për shkak të jetëgjatësisë më të madhe të pajisjeve.

Bizneset dhe NVM-të

- Cilësore: përballen me kosto fillestare për testim, certifikim dhe dokumentacion teknik, por fitojnë avantazh konkurrues përmes përputhjes me standardet e BE-së; krijojnë imazh më të qëndrueshëm dhe përgjegjës.
- Sasiore: kostot fillestare për përshtatjen e produkteve mund të variojnë në 2–5% të çmimit për njësi; megjithatë, kjo shoqërohet me mundësi për hyrje në tregje të reja dhe përmirësim të aksesit në financime
- NVM-të: janë më të ekspozuara ndaj kostove fillestare, por pritet të përfitojnë nga programet mbështetëse të qeverisë dhe donatorëve (subvencione për pajisje testimi, asistencë teknike për certifikim).

Importuesit dhe tregtarët

- Cilësore: detyrohen të sigurojnë dokumentacion të plotë dhe pasaportë digjitale për produktet; eliminohet avantazhi i padrejtë i produkteve jo-konformë; rritet besimi i konsumatorëve.
- Sasiore: kosto shtesë administrative për përgatitjen e dosjeve teknike dhe përditësimin e bazave të të dhënave (1–3% e qarkullimit vjetor për disa operatorë).

Institucionet publike

- Cilësore: përmirësojnë kapacitetet mbikëqyrëse; forcojnë integrimin evropian; raportojnë më qartë mbi progresin drejt PKEK dhe Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike.
- Sasiore: kostot për inspekte shtesë dhe zhvillimin e sistemeve të raportimit janë të kufizuara, pasi ISHMT dhe MIE tashmë kanë strukturat bazë. Financimi do të mbështetet nga buxheti i shtetit dhe programet IPA III.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ekonomike

- Rritje e konkurrencës së ndershme, pasi produktet jo-eficiente nuk do të kenë më avantazh në çmim.
- Nxitje e inovacionit dhe zhvillimit të teknologjive të reja; mundësi për zgjerim të industrive të riparimit dhe riciklimit.

Shoqërore

- Rritje e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e energjisë dhe ndikimin mjedisor; edukim i qytetarëve përmes pasaportës digjitale të produktit.
- Rrezik potencial që produktet më eficiente të kenë kosto më të larta fillestare, çka mund të ndikojë te familjet me të ardhura të ulëta. Për këtë arsye, nevojiten mekanizma mbështetës (p.sh., subvencione për pajisje shtëpiake eficiente).

Mjedisore

- Kontribut i drejtpërdrejtë në uljen e konsumit final të energjisë me 8.4% deri në 2030, sipas PKEK.
- Reduktim i emetimeve të GHG me 18.7% deri në 2030, duke përmbushur objektivat e NECP dhe Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike.
- Reduktim i mbetjeve elektronike dhe rritje e riciklueshmërisë.

Ndikimet në raport me politikat dhe dokumentet strategjike

- Ligji 52/2024 për etiketimin: ky ligj është bazë plotësuese, duke garantuar që informacioni mbi efikasitetin energjetik shoqëron produktet. Projektligji për projektimin ekologjik e forcon këtë kuadër duke adresuar edhe aspektet e dizajnit, jetëgjatësisë dhe riciklimit.
- NECP 2021–2030: objektivat për eficiencën energjetike dhe reduktimin e GHG mbështeten drejtpërdrejt.
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 dhe Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike: përmirësimi i efikasitetit të produkteve ul presionin mbi infrastrukturën energjetike dhe kontribuon në rezistencën klimatike.
- Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe Plani i Rritjes: nisma e vendos Shqipërinë në linjë me prioritetet rajonale për tranzicion të gjellbër.

Kufizimet e analizës dhe rreziqet

- Supozimi kryesor është se konsumatorët do ta përdorin informacionin e pasaportës digjitale për të bërë zgjedhje më të mira; rreziku që ky informacion të mos shfrytëzohet plotësisht ekziston.
- Rezistenca e mundshme nga operatorët ekonomikë për shkak të kostove fillestare.
- Vonesa në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe në ngritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse mund të kufizojnë efektin e menjëhershëm.
- Rrezik i kufizuar i rritjes së çmimeve fillestare të produkteve në treg, që mund të kërkojë masa kompensuese për grupet vulnerabël.

Përmbledhja e vlerësimit të opsioneve

- Opsioni 0 – Status quo: nuk ofron përfitime, mban boshllëqet ligjore, pengon përmbushjen e PKEK dhe angazhimeve ndërkombëtare.
- Opsioni 1 – Ndryshime të pjesshme: ofron përmirësime të kufizuara, por mbetet i pamjaftueshëm për përafrim të plotë me BE dhe nuk garanton stabilitet afatgjatë.
- Opsioni 2 – Ligj i ri për projektimin ekologjik (opsioni i preferuar): siguron kuadër modern dhe gjithëpërfshirës, përmbush objektivat energjetike dhe klimatike, mbështet konkurrencën e ndershme, fuqizon konsumatorët dhe integron Shqipërinë në standardet e BE-së.

Grupi i prekur	Ndikime ekonomike	Ndikime sociale	Ndikime mjedisore
Konsumatorët	Kursime në fatura energjie (10–15% afatgjatë); ulje e kostove të mirëmbajtjes.	Vendimmarrje më e vetëdijshme; transparencë më e madhe.	Ulje e konsumit final të energjisë; reduktim i GHG.
Bizneset dhe NVM	Kosto fillestare (2–5% të çmimit për njësi); rritje e aksesit në tregje dhe financime.	Kulturë biznesi më e qëndrueshme; inovacion.	Produkte më të qëndrueshme; nxitje e ekonomisë qarkulluese.
Importuesit tregtarët	Eliminim i avantazhit të padrejtë të produkteve jo-konformë.	Marrëdhënie më të mira me konsumatorët.	Zvogëlim i mbetjeve elektronike dhe produkteve jo-eficiente.
Institucionet publike	Pa kosto të konsiderueshme shtesë; financim nga IPA dhe buxheti i shtetit.	Rol më i fortë në mbrojtjen e konsumatorit.	Mbështetje për objektivat: –8.4% konsum energjie, –18.7% GHG deri në 2030.
Shoqëria civile / publiku	Përfitime indirekte përmes rritjes së transparencës.	Fuqizim i qytetarëve; kulturë e qëndrueshme.	Përmirësim i cilësisë së ajrit dhe reduktim i mbetjeve.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i zgjedhur është miratimi i një ligji të ri për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji. Ky opsion u vlerësua si më i përshtatshmi, pasi krijon një kuadër ligjor modern, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar me standardet e BE-së, duke tejkaluar kufizimet e opsioneve të tjera (status quo ose ndryshime të pjesshme) dhe duke ofruar bazën e duhur për zhvillim afatgjatë.

1. Mbushja e boshllëkut ligjor dhe forcimi i tregut vendas

Një ndër arsyt kryesore të zgjedhjes së këtij opsioni është adresimi i boshllëkut ligjor që ekziston aktualisht në Shqipëri. Ligji për etiketimin e produkteve me ndikim në energji (Ligji nr. 52/2024) trajton transparencën për konsumatorin, por nuk mbulon aspektin e projektimit ekologjik, pra kushtet teknike dhe mjedisore që një produkt duhet të plotësojë para se të hyjë në treg. Pa këtë ligj, tregu shqiptar do të mbetej i pambrojtur nga importi i produkteve jo-eficiente dhe jo të qëndrueshme, duke krijuar kosto të larta për konsumatorët dhe dëmim për bizneset korrekte.

2. Përafrimi me *acquis* të BE-së dhe përgatitja për zhvillime të reja

Ky opsion siguron transpozimin e Direktivës 2009/125/EC në legjislacionin shqiptar, si dhe integrimin gradual të elementeve të Rregullores (BE) 2024/1781, që i referohet produkteve me ndikim në energji. Kjo e bën tregun shqiptar të harmonizuar me rregullat e përbashkëta evropiane, duke lehtësuar shkëmbimet tregtare dhe duke përgatitur industrinë dhe importuesit për rregullime më specifike në të ardhmen. Për më tepër, ky përafrim përkon drejtpërdrejt me Kapitullin 1 dhe Kapitullin 15 të procesit të integritimit evropian.

3. Përfitime për konsumatorët dhe mbrojtje sociale

Ligji i ri garanton që çdo produkt me ndikim në energji në treg të shoqërohet me informacion standard mbi eficiencën energjetike, jetëgjatësinë dhe mundësinë e riciklimit. Kjo rrit transparencën dhe fuqizon konsumatorët të bëjnë zgjedhje më të informuara, duke ulur faturat e energjisë deri në 10–15% afatgjatë dhe duke përmirësuar cilësinë e jetesës. Në të njëjtën kohë, vendosja e standardeve të detyrueshme do të kufizojë qarkullimin e produkteve jo të sigurta dhe me ndikim të lartë mjedisor, duke mbrojtur qytetarët nga rreziqet shëndetësore dhe financiare.

4. Mbështetje për bizneset dhe NVM-të

Opsioni i miratimit të ligjit të ri është më i favorshëm edhe për bizneset dhe NVM-të. Edhe pse fillimisht sjell kosto për testim, certifikim dhe përshtatje, në afatgjatë i lejon ato të fitojnë akses të reja në tregjet evropiane dhe të rrisin reputacionin e tyre si operatorë të përgjegjshëm. Përveç kësaj, programet e mbështetjes nga BE dhe donatorët ndërkombëtarë do të lehtësojnë tranzicionin, duke mbuluar një pjesë të kostove për SME-të dhe duke siguruar asistencë teknike.

5. Kontribut në objektivat energjetike dhe klimatike

Ligji i ri lidhet drejtpërdrejt me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2021–2030, i cili synon:

- një ulje prej 8.4% të konsumit final të energjisë deri në vitin 2030 përmes masave të eficiencës;
- një reduktim prej 18.7% të emetimeve të gazeve serrë (GHG) deri në vitin 2030.

Këto objektiva mbështeten nga miratimi i ligjit, pasi në treg do të lejohen vetëm produkte më eficiente, duke reduktuar konsumin total të energjisë dhe duke ulur ndjeshëm gjurmën e karbonit. Në këtë mënyrë, Shqipëria forcon rolin e saj në përmbushjen e Marrëveshjes së Parisit, Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike.

6. Efikasitet administrativ dhe qartësi ligjore

Ndryshe nga opsionet e pjesshme që do të kërkonin ndryshime të shpeshta dhe rrezikonin fragmentim ligjor, miratimi i një ligji të ri të integruar ofron një pikë unike referimi për administratën, bizneset dhe konsumatorët. Kjo rrit efikasitetin e administratës publike, ul kostot e tranzicionit dhe e bën procesin e zbatimit më të qartë dhe më të parashikueshëm.

7. Ndikime sociale, mjedisore dhe ekonomike afatgjata

Ky opsion siguron përfitime të shumëfishta:

- Ekonomike: kursime për konsumatorët, nxitje e inovacionit dhe e investimeve në teknologji të pastra, mundësi të reja pune në riparim dhe riciklim.

- Shoqërore: ndërgjegjësim i shtuar, rritje e cilësisë së jetesës dhe mbrojtje e konsumatorit.
- Mjedisore: reduktim i konsumit të energjisë, ulje e emetimeve të CO₂ dhe zvogëlim i mbetjeve elektronike.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, nga përafrimi evropian dhe besueshmëria ndërkombëtare, deri te përfitimet konkrete për konsumatorët, bizneset dhe mjedisin, opsioni i miratimit të një ligji të ri për projektimin ekologjik është zgjidhja më e qëndrueshme, më gjithëpërfshirëse dhe më afatgjatë. Ai garanton jo vetëm përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, por edhe krijimin e një tregu më të sigurt, më transparent dhe më konkurrues, duke mbështetur tranzicionin e gjelbër të Shqipërisë dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.

Zbatimi i ligjit për projektimin ekologjik do të kërkojë koordinim të gjerë institucional. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të mbetet institucioni përgjegjës kryesor, duke hartuar aktet nënligjore, udhëzimet teknike dhe duke siguruar harmonizimin me kuadrin evropian. Në këtë kuadër, MIE do të ketë rol udhëheqës si përfaqësuese e Shqipërisë në raportimet ndaj Komunitetit të Energjisë dhe Komisionit Evropian.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) do të ketë funksion shtesë për integrimin e kërkesave mjedisore në standardet e projektimit ekologjik, për të garantuar që këto nuk kufizohen vetëm në eficiencën e energjisë, por adresojnë gjithashtu reduktimin e emetimeve, menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) do të zbatojë kontrollet në terren. Duke qenë se Shqipëria është një vend importues neto i produkteve me ndikim në energji, ISHMT do të ketë përgjegjësi të posaçme për inspektimin në pikat e doganës dhe tregjet e brendshme, duke parandaluar futjen në treg të produkteve që nuk përmbushin standardet.

Drejtoria e Standardeve dhe Certifikimit (p.sh. DPS ose një strukturë e ngjashme) do të mbështesë procesin teknik të përshtatjes së standardeve europiane dhe të akreditimit të laboratorëve kombëtarë. Në këtë drejtim, bashkëpunimi me Drejtorinë e Doganave është i domosdoshëm, pasi shumë prej kontrolleve do të ndodhin në momentin e hyrjes së produkteve në vend.

Një rol mbështetës i rëndësishëm pritet edhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), e cila do të monitorojë ndikimet mjedisore dhe do të raportojë mbi efektet e aplikimit të politikës në reduktimin e konsumit të energjisë dhe të gazeve me efekt serrë.

Pengesat e mundshme për zbatim

1. Kapacitetet administrative të kufizuara: mungesa e stafit të specializuar për të interpretuar dhe zbatuar standardet e projektimit ekologjik mbetet një rrezik.
2. Infrastruktura teknike: mungesa e laboratorëve të akredituar në vend do të detyrojë përdorimin e laboratorëve të huaj, duke rritur kostot për bizneset.
3. Kosto për bizneset, veçanërisht SME-të: bizneset e vogla e të mesme do të kenë vështirësi financiare dhe teknike për t'u përshtatur me standardet e reja.
4. Ndërgjegjësimi i ulët i konsumatorëve: konsumatorët shqiptarë shpesh i kushtojnë më shumë vëmendje çmimit fillestar sesa kostos së përdorimit gjatë gjithë jetës së produktit.
5. Rreziku i tregut informal: tregtimi i produkteve jo-konform nga kanale informale (jo zyrtare) mund të minojë efektivitetin e politikës.
6. Vështirësitë e harmonizimit me BE: për shkak të shpejtësisë së ndryshimeve në nivel europian (p.sh. kalimi nga direktiva në rregullore), Shqipëria mund të ketë vonesa në transpozim dhe zbatim.

Masat e zbatimit për arritjen e objektivave

1. Hartimi dhe miratimi i akteve zbatuese

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, MIE do të hartojë aktet nënligjore specifike për çdo kategori produktesh, duke përcaktuar kërkesat teknike dhe standardet e projektimit ekologjik. Këto do të miratohen në konsultim të ngushtë me grupet e interesit dhe do të përditësohen periodikisht sipas zhvillimeve në BE.

2. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të tregut

ISHMT do të zhvillojë plane inspektimi vjetore, me prioritet të produktet që kanë ndikimin më të madh në konsumin e energjisë dhe emetimet. Përveç inspektimeve në terren, do të krijohet një regjistër elektronik i pajisjeve të certifikuara, që do të shërbejë si bazë për verifikimin e produkteve të lejuara në treg.

3. Investimi në infrastrukturë teknike

Do të mbështetet ngritja ose pajisja e laboratorëve kombëtarë me teknologji moderne për testimin e eficiencës së energjisë dhe parametrave të tjerë të projektimit ekologjik. Deri në arritjen e kapaciteteve vendase, do të përdoren marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë të akredituar ndërkombëtarë.

4. Mbështetja e bizneseve dhe SME-ve

Qeveria do të ndërmarrë skema të posaçme për të lehtësuar barrën financiare të bizneseve të vogla. Këto përfshijnë: grante, kredi të buta, përjashtime fiskale për importin e pajisjeve më eficiente, si dhe udhëzues praktikë dhe trajnime për përshtatjen me standardet.

5. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve

Do të zhvillohen fushata kombëtare për të promovuar përdorimin e produkteve ekologjike. Qytetarët do të informohen mbi përfitimet afatgjata të këtyre produkteve, si kursimi i energjisë, ulja e faturave mujore dhe mbrojtja e mjedisit. Për këtë, pritet bashkëpunim me media, OJF dhe institucione arsimore.

6. Monitorimi dhe raportimi i progresit

AKM dhe MIE do të hartojnë mekanizma monitorimi me indikatorë të qartë (kursimi i energjisë, reduktimi i emetimeve, rritja e produkteve ekologjike në treg). Raportet do t'i dërgohen Këshillit të Ministrave dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë çdo vit. Rezultatet do të publikohen për transparencë dhe llogaridhënie.

7. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shqipëria do të përfitojë nga programet e BE-së dhe organizatave financiare ndërkombëtare për mbështetje teknike dhe financiare. Kjo përfshin projekte pilot, asistencë për laboratorët, trajnime dhe shkëmbime eksperiencash me vendet e BE-së.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikës për projektimin ekologjik është thelbësor për të siguruar se objektivat e përcaktuara arrihen dhe se masat ndërmarrin ndikimin e pritur në treg, ekonomi, shoqëri dhe mjedis. Procesi do të përfshijë mekanizma të vazhdueshëm të kontrollit, raportimit dhe rishikimit periodik të ligjit dhe akteve nënligjore, duke garantuar përshtatshmërinë me standardet e BE-së dhe përditësimin sipas zhvillimeve teknologjike dhe tregtare.

Masat e Monitorimit dhe Vlerësimit

1. Monitorimi i zbatimit të legjislacionit
 - Inspektime të rregullta nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe strukturat e tjera përkatëse.
 - Raportim i gjetjeve nga kontrollet e tregut dhe nga autoritetet doganore mbi produktet e futura në treg.
 - Përditësim i regjistrit elektronik të produkteve të certifikuara.
2. Mbledhja e të dhënave mbi ndikimin në treg
 - Raportimi i numrit dhe llojit të produkteve që certifikohen dhe plotësojnë standardet e projektimit ekologjik.
 - Analiza e prirjeve të tregut për të matur nivelin e adoptimit të produkteve më eficiente dhe ekologjike.
3. Vlerësimi i ndikimit ekonomik dhe mjedisor
 - Matja e kursimit të energjisë dhe reduktimit të konsumit të burimeve natyrore.
 - Vlerësimi i reduktimeve të gazeve serrë, në përputhje me objektivat e PKEK 2021–2030.
 - Përlllogaritja e përfitimeve ekonomike për konsumatorët dhe bizneset.
4. Vlerësimi i ndërgjegjësimit publik dhe të bizneseve
 - Kryerja e sondazheve periodike me konsumatorë dhe biznese për nivelin e njohjes dhe zbatimit të ligjit.

- Analiza e perceptimit të konsumatorëve mbi përfitimet ekonomike dhe mjedisore të produkteve të reja.
5. Raportimi dhe rishikimi periodik
- Raporte vjetore mbi zbatimin dhe progresin e arritur, të përgatitura nga MIE dhe AKM.
 - Rishikim i politikës çdo 3–5 vjet për të përshtatur objektivat dhe standardet sipas zhvillimeve të BE-së.
 - Përfshirje e shoqërisë civile dhe aktorëve të tregut në procesin e konsultimit.

Burimet e Financimit

- Buxheti i Shtetit: financimi i strukturave përgjegjëse, inspektimeve dhe kostove administrative.
- Donatorët ndërkombëtarë: projekte për ndërgjegjësim, asistencë teknike dhe mbështetje për SME-të.

Kriteri	Treguesi kryesor	Afati i monitorimit	Burimi i të dhënave
Zbatimi i kuadrit ligjor	Ligji i miratuar, numri i akteve nënligjore të nxjerra	Një herë / Vjetor	Fletorja Zyrtare, MIE
Mbikëqyrja e tregut	Nr. i inspektimeve dhe raportimeve mbi pajtueshmërinë	Tremujor / Vjetor	ISHMT, Doganat
Ndikimi në treg	% e produkteve që plotësojnë kërkesat ekologjike	Vjetor	Raportet e tregut
Ndikimi ekonomik	Kursime mesatare në fatura dhe kosto operimi për SME	Vjetor	Anketa dhe raporte
Ndikimi mjedisor	Reduktimi i konsumit final të energjisë, GHG	Vjetor	AKM, PKEK
Ndërgjegjësimi publik dhe biznese	% e qytetarëve/bizneseve që raportojnë informim të plotë	Çdo 2 vjet	Sondazhe kombëtare

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë në kuadër të instrumentit të bashkimit evropian “ <i>Faciliteti për reforma dhe rritje për ballkanin perëndimor</i> ” qeveria shqiptare do të përfitojë shumën e financimit të parashikuar në masën 600 milionë lekë.										

Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	Pagat e punonjesve te MIE hartojne politikat dhe pagat e punonjesve te ISHMT per inspektimin e produkteve me ndikim ne energji.		3617028
Opsioni 2	Pagat e punonjesve te MIE hartojne politikat dhe pagat e punonjesve te ISHMT per inspektimin e produkteve me ndikim ne energji.		3617028

MINISTËR

[Emri Mbiemri]